

RAPORT MUJOR I FONDIT TË PENSIONIT PRIVAT “SMART PENSION”**PRILL 2025****Emërtimi i Fondit:** Fondi i Pensionit Privat me pjesëmarrje të hapur, Smart Pension (“Fondi”)**Shoqëria Administruese:** Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Privat dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, Albsig Invest sh.a.**Monedha Bazë:** Lekë

Politika e Investimit: Fondi ka një tolerancë të ulët rreziku (konservator) duke respektuar parimin e sigurisë, diversifikimit dhe mbajtjes së likuiditetit të përshtatshëm për investimet afatgjata. Fondi do të investojë kryesisht në tituj borxhi (obligacione) afatgjatë të emetuar ose të garantuar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë. Objektivi i investimit është rritja e të ardhurave duke ruajtur principalin dhe horizonti i investimit është afatgjatë.

PROFILI I RREZIKUT DHE PËRFITIMIT**RREZIK I ULËT***Përfitime zakonisht të ulëta***RREZIK I LARTË***Përfitime zakonisht të larta*

1	2	3	4	5	6	7
---	---	---	---	---	---	---

Fondi bie në kategorinë e parë të profilit të rrezikut, e cila është kategoria me rrezikut më të ulët. Kategoria e rrezikut përbën një rrezik sintetik i cili llogaritet duke u bazuar në luhatshmërinë e Fondit. Luhatshmëria e lartë ka një indikator rreziku më të lartë dhe një luhatshmëri më e ulët ka një indikator rreziku më të ulët.

Të dhënat kryesore për Fondin më 30.04.2025

Vlera Neto e Aktiveve :	88,850,865.76
Çmimi për kuotë:	1,120.9705
*Kthimi nga Investimit (30 Prill 2024-30 Prill 2025):	5.42%


Tarifa e administrimit dhe tarifat e tjera zbriten përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.*KOSTOT DHE TARIFAT**

- Komisioni vjetor i administrimit do jetë 1.2% në vit e vlerës neto të aktiveve të Fondit.
- Komisioni vjetor i auditimit të Fondit është sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese.
- Komisioni i depozitarit të Fondit
- Tarifa e Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare (AMF) do jetë 0.05% në vit e vlerës së aktiveve të Fondit..
- Komisionet e transaksionve me titujt në emër të Fondit.

Kostoja totale që do t’i mbahet Fondit nuk mund të kalojë në asnjë rast 1.5% të vlerës neto të aktiveve të Fondit.

SHPËRNDARJA E AKTIVEVE

Kategoria e Aktiveve	Vlera (në lekë)	% ndaj Aktiveve
Tituj të emetuar dhe garantuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë.	81,676,606	92%
Llogari rrjedhëse dhe depozita në banka të licencuara nga Banka e Shqipërisë.	7,282,236	8%

ECURIA E ÇMIMIT PËR KUOTË DHE PERFORMANCA E FONDIT.


Kthimi jetorë neto rezulton 5.42% për periudhën 30 Prill 2024-30 Prill 2025.

Më poshtë shfaqen kthimet vjetore të Fondit për periudhat 1 vjeçare dhe 2 vjeçare deri më 30 Prill 2025.

Performanca e kaluar nuk duhet të përdoret si udhëzues për performancën në të ardhmen.

Fondi ka filluar aktivitetin në **12.01.2023**.

Smart Pension	5Y	3Y	2Y	1Y
	-	-	5.36%	5.42%
Norma Vjetore e Kthimit				